



Viza për vizita të shkurtra në Zonën Schengen (Viza Schengen)

Informacion për zotëruesit e pasaportës në Republikën e Shqipërisë

Ju mund të udhëtoni me një vizë të vlefshme Schengen në Shtetet Anëtare të mëposhtme dhe Shtetet e asociuar që zbatojnë plotësisht *Acqui-në Schengen*: Austria, Belgjika, Republika Çeke, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Greqia, Gjermania, Holanda, Hungaria, Islanda, Italia, Lituania, Letonia, Luksemburgu, Malta, Norvegjia, Polonia, Portugalia, Sllovakia, Sllovenia, Spanja, Suedia dhe Zvicra. Kjo vizë i jep të drejtën zotëruesit të qëndrojë për një periudhë maksimale prej 90 ditësh brenda 6 muajve, duke filluar nga data e hyrjes së parë.

Jeni të lutur të vini re që zotërimi i një vize Schengen nuk u jep juve të drejtën e hyrjes; kushtet e hyrjes verifikohen edhe në kufijtë e jashtëm.

Kërkesa për vizë duhet t'i drejtohet misionit diplomatik të shtetit që është destinacioni juaj kryesor i udhëtimit (ose misionit diplomatik të shtetit që përfaqëson atë shtet, sipas rastit). Nëse destinacioni kryesor nuk mund të përcaktohet, kërkesa duhet t'i paraqitet misionit diplomatik të shtetit të parë Schengen ku ju futeni.

Tarifa e kërkesës për vizë është 35 Euro. Tarifa paguhet në Lek të llogaritur kundrejt normës përkatëse të këmbimit¹. Nëse kërkesa për vizë refuzohet, tarifa nuk kthehet. Tarifat për vizë nuk zbatohen për kategoritë e kërkuesve të renditur në Nenin 6(2) të Marrëveshjes së Lehtësimit të Vizave (VFA)² (p.sh, të afërmit e afërt, anëtarët e delegacioneve zyrtare, fëmijët nën 6 vjeç, personat me aftësi të kufizuar, pensionistët, gazetarët etj).

Ju lutem, kini parasysh se informacioni në këtë dokument është i përgjithshëm dhe seksioni i vizare ka të drejtën të kerkojë dokumenta të tjera shtesë në mbështetje të aplikimit.

¹ **Zvicër:** tarifa për vizë për qytetarët e Shqipërisë është 60 Euro, që paguhet në Lek të llogaritur kundrejt normës përkatëse të këmbimit. **Republika Çeke, Hungaria, Greqia:** tarifa për vizë paguhet në Euro (35 Euro).

² Teksti i plotë i VFA-së është në faqen e mëposhtme të internetit:

http://www.delalib.ec.europa.eu/files/visa_facilitation_agreement-EU_Official_Journal.pdf

VFA-ja nuk është akoma e zbatueshme për **Zvicrën**.

Me qëllim që të bëhet kërkesë për vizë Schengen, dokumentet e mëposhtme duhet të paraqiten personalisht:

- Një pasaportë e vlefshme dhe fotokopje e të gjitha faqeve të pasaportës që përmbajnë informacion. Pasaporta duhet të jetë e vlefshme për të paktën tre muaj pas skadimit të vizës;
- Një formular i plotësuar i kërkesës i nënshkruar rregullisht nga kërkuesi. Formularë bosh të kërkesës mund të merren falas në Ambasadën e një Shteti Anëtar Schengen ose mund të shkarkohet nga faqet e tyre të internetit;
- Dy fotografi të madhësisë së pasaportës të marra në një sfond të bardhë sipas standardeve të zakonshme ICAO;
- Certifikata³ të lindjes dhe familjare të kërkuesit ose një kopje të kartës biometrike të identitetit;
- Për fëmijët e pashoqëruar nën 18 vjeç: një deklaratë e noteruar nga prindi që nuk udhëton⁴;
- Për studentët: një letër nga shkolla ose universiteti⁵;
- Sigurimi i udhëtimit/shëndetit (të vlefshëm për të gjithë Shtetet Anëtare Schengen që mbulojnë një shumë minimale prej 30 000 Euro për trajtim mjekësor dhe kthimin e kërkuesit në rast shëndeti të dobët).

³ **Hungari**: certifikohet me Apostile

⁴ **Itali**: deklarimi i noteruar kërkohet nga të dy prindërit. **Republika Çeke**: deklarimi kërkohet për udhëtimin e fëmijëve të pashoqëruar nën 15 vjeç.

⁵ **Hungari**: në Anglisht.

Në varësi të arsyeve të udhëtimit, ju duhet të paraqisni edhe këto dokumente:

Vizë si vizitor

- Garanci mbështetjeje nga personi pritës (dhe një fotokopje) ⁶ ose prova që ka mjete të mjaftueshme financiare që ka kërkuesi (d.m.th, deklaratimet bankës së tij/saj që tregojnë një periudhë operimi të paktën tre muaj, certifikata pensioni ose të sigurimeve shoqërore, kontratë punësimi)
- Nëse kërkuesi dhe sponsori / personi pritës kanë lidhje familjare ose gjaku, kërkuesi duhet të paraqesë dokumentet që provojnë marrëdhënien (p.sh, certifikata lindjeje ose martese);
- Letër punësimi ose dokumente regjistrimi biznesi nëse kërkuesi ka biznesin e tij / saj – d.m.th, vendim gjyqësor për përfundimin e licencës së biznesit, licencë biznesi dhe NIPT-in e shoqërisë;
- Rezervimin e udhëtimit (fluturim ose autobus, nuk është e nevojshme të paraqitet bileta e paguar)
- Dokumenti shtesë i kërkuar nga Greqia – shih ⁷

Viza si turist

- Provë të mjeteve të mjaftueshme financiare – p.sh, deklaratimet bankës personale të kërkuesit që tregojnë një periudhë operimi të paktën tre muaj, letër punësimi, ose kontratë punësimi, certifikata të sigurimeve shoqërore, dokumente regjistrimi biznesi nëse kërkuesi ka biznesin e tij / saj – d.m.th, vendim gjyqësor për përfundimin e licencës së biznesit, licencë biznesi dhe NIPT-in e shoqërisë;
- Rezervimin e hotelit dhe udhëtimit (nuk është e nevojshme të paraqitet bileta e paguar).

⁶ **Republika Çeke:** Ftesë nga personi pritës i vërtetuar nga autoritetet e vendit të destinacionit.

Greqia: Ftesë nga personi pritës i vërtetuar nga autoritetet përkatëse greke, prova AND ose mjete të mjaftueshme financiare.

Hungaria: Ftese nga personi pritës e certifikuar nga autoritetet hungareze dhe prova për mjete të mjaftueshme financiare, duke përfshirë vërtetimin nga Zyra e Tatimeve. Strehim i vërtetuar (p.sh, kontratë qiraje ose një dokument nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive që vërteton pronësinë mbi një apartament që është lëshuar në ter muajt e fundit). Një fotokopje e kartës së identitetit të personit pritës në rast se ajo/ai është qytetar hungarez ose një kopje të lejes së saj/tij të qëndrimit, nëse ajo/ai është qytetar i huaj në Hungari.

Italia: Ftesë nga personi pritës dhe një fotografi e kartës së identitetit të personit pritës në rast se ai/ajo është një qytetare italiane ose një kopje të lejes së tij/saj të qëndrimit nëse ai/ajo është shtetase shqiptare. Personi pritës mund të veprojë si garantues që jep mjetet financiare për kërkuesin (p.sh, “fidejussione bancaria”, etj.)

Zvicër: garanci mbështetjeje nuk kërkohet për shkak të një procedure tjetër. Një letër ftesë nga pritësi në Zvicër është e mjaftueshme për të filluar procedurën.

⁷ Përveç kësaj, **Greqia** kërkon një fotokopje të personit pritës në rastin kur ai/ajo është një qytetar grek ose një kopje të lejes së tij/saj të banimit nëse ai/ajo është qytetar shqiptar. Këto fotografi duhet të vërtetohen nga autoritetet greke.

Vizë Biznesi

- Letër kërkesë / ftesë me shkrim⁸ nga shoqëria pritëse ose personi juridik, zyra, shteti ose autoriteti lokal dhe duhet të verifikohet ekzistenca e një biznesi në Qendrën Kombëtare Shqiptare të Regjistrimit. Ftesa duhet të lëshohet jo më shumë se 2 muaj para datës së kërkesës;
- OSE letër nga një shoqëri shqiptare, që përmban hollësitë tuaja personale, rolin tuaj në biznes dhe qëllimin dhe gjatësinë e udhëtimit (origjinale ose kopje). Letra duhet të lëshohet jo më vonë se 2 muaj para datës së kërkesës DHE letër ftesa nga shoqëria pritëse që konfirmon që ajo do të mbulojë shpenzimet financiare, ose prova të mjeteve të mjaftueshme financiare (për shembull, deklarin të bankës personale dhe/ose një certifikatë nga punëdhënësi që konfirmon që ai do të mbulojë shpenzimet)

Nëse ka një ortakëri biznesi me shoqërinë pritëse, prova që provojnë ekzistencën e saj (fatura, lista të porosive të produkteve, etj)

- Letër punësimi i kërkuesit⁹
- Dokumente të regjistrimit të biznesit të shoqërisë ku kërkuesi punon (vendim gjyqësor për përfundimin e licencës së biznesit, licencën e biznesit dhe NIPT-in e shoqërisë)
- Prenotimin e hotelit dhe udhëtimit¹⁰ (nuk është e nevojshme të paraqitet bileta e paguar).

Vizë për të marrë pjesë në Aktivitete Kulture dhe Shkencore

- Një kërkesë me shkrim / letër ftesë nga institucioni pritës për të marrë pjesë në Aktivitet;
- Një letër ftesë nga institucioni pritës që konfirmon që ai do të mbulojë shpenzimet financiare, ose prova të mjeteve të mjaftueshme financiare (për shembull një deklarin të bankës personale);
- Letër punësimi ose arsimit dhe dokumente të regjistrimit të biznesit (licencë biznesi);
- Rezervimin e hotelit dhe udhëtimit (nuk është e nevojshme të paraqitet bileta e paguar).

⁸ Kjo kërkesë me shkrim duhet të përmbajë hollësitë e renditura në VA, Neni 4(2). Teksti i plotë i VFA-së është në faqen e mëposhtme të Internetit:

http://www.delalb.ec.europa.eu/files/visa_facilitation_agreement-EU_Official_Journal.pdf

⁹ Përveç kësaj, **Greqia**, **Hungaria** dhe **Italia** kërkon kontratën e punësimit dhe certifikatën e sigurimeve shoqërore të kërkuesit.

Përveç kësaj, **Gjermania** kërkon një fotokopje të një patente ndërkombëtare ose kombëtare për shoferët që sjellin automjete në Shqipëri.

¹⁰ Nuk kërkohet nga **Greqia**, nuk kërkohet nga **Italia**

Viza për shoferë që bëjnë shërbime të transportit ndërkombëtar të mallrave dhe pasagjerëve¹¹

- Një kërkesë me shkrim nga shoqata kombëtare e transportuesve të Shqipërisë që sigurojnë transport rrugor ndërkombëtar, duke deklaruar qëllimin, kohëzgjatjen dhe shpeshtësinë e udhëtimeve;
- Prova të mjeteve të mjaftueshme financiare (për shembull, një deklaram të bankës personale dhe/ose letër nga punëdhënësi që konfirmon që ai do të mbulojë shpenzimet)
- letër punësimi ose dokumente të regjistrimit të biznesit (licencë biznesi);
- Fotokopje të lejes së drejtimit të vlefshme ndërkombëtare dhe kombëtare;
- Dokumente të regjistrimit të automjetit.

Jeni të lutur të vini re që seksioni i rezervon të drejtën për të kërkuar dokumente shtesë në mbështetje të kërkesës.

¹¹ Ky rregullim është i vlefshëm vetëm për shoferët e autobusëve dhe kamionëve të përfshirë në transportin ndërkombëtar të mallrave dhe pasagjerëve në Zonën e Schengenit, që drejtojnë automjete të regjistruara vetëm në Republikën e Shqipërisë.